

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/erion-veliaj-kerkon-te-kthehet-ne-vendin-e-it-i474148
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:28:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:02:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	98ac6fea0948c58f93c093f815abdde488de581dd24ad78b08e338b578301ff0
TEKSTI	b8551f854b7382ec4904c1a84c5311e087ec83595ec4140c7f4e10f588ab6bbb
PAMJA	3f824cd40f9504fa5aa2f91a26755f8591422f8bd0370c771fb51898fe5b6c5b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d4a07071252153480d121480dc74550d36883558434a8ebb729be0cff707a940
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d4a07071252153480d121480dc74550d36883558434a8ebb729be0cff707a940>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

19:04 Aktualitet

Biznesmeni i njohur Gjergj Luca ka zgjeruar rrjetin e bizn...

Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit



14 Shtator 2026, 19:02, Aktualitet CNA



Gjykata e Lartë nesër pritet të japë vendimin pas kërkesës së bërë nga Erion Veliaj se ai është i njohur si kryetar bashkie nga Gjykata Kushtetuese dhe duhet të kthehet në detyrë. Këtë e ka thënë sot dhe avokati i tij, i pandehuri i SPAK, Plarent Ndreca, i cili thekson se Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar masën e sigurisë së Veliajt prandaj dhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese është Gjykata e Lartë që sipas propagandës së këtyre juristëve që kanë nevojë të fillojnë të lexojnë abetaren, Erion Veliaj duhet të shkojë në zyrë.





Avokati i pandehur mashtron për llogari të Veliajt

1-Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit

Në gati 19 muaj nga arrestimi i Erion Veliajt, kryebashkiakut të Tiranës, nuk ka ndryshuar asgjë në favor të tij që të ndryshojë masa e sigurisë. Ka qenë kryetar bashkie në momentin e arrestimit dhe të 13 akuzat lidhen me detyrën e tij pikërisht me faktin që është kryetar bashkie dhe Erion Veliaj kërkon që të kthehet në detyrë, kërkon të kthehet në vendin ku ka kryer krimin, pra ku ka kryer 13 veprat e rënda penale.



SPAK kopsit dosjen/ 13 akuza për Erion Veliajn

2-Erion Veliaj nuk i kërkon dot Gjykatës ndryshim mase, pasi prej 14 muajsh nuk shkon në gjykatë

Erion Veliaj nuk ka shkuar para gjykatës të thotë se unë kam bashkëpunuar me drejtësinë, më kanë rënë këto akuza, kam qenë një bashkëpunëtor i drejtësisë ose kam ndjekur një proces shumë të rregullt ligjor, kam qenë korrekt me drejtësinë dhe duhet të më ndryshojë masa e sigurisë, duhet të jem i lirë, duhet të shkoj në shtëpi të fëmijët ose të kem një masë të butë sigurie, arrest në shtëpi ose detyrim me paraqitje. Jo. Këtë nuk e bën dot Erion Veliaj nuk ia kërkon dot gjykatës se Erion Veliaj prej 14 muajsh nuk shkon në gjykatë, nuk paraqitet, por çfarë nuk ka bërë për të prishur procesin.



Erion Veliaj, prej një viti e tre muaj nuk pranon të gjykohe

Problemi nuk është vetëm shtyrja pafund e procesit, problemi është te fakti po u rikthye në detyrë sërish ai jo vetëm mund të përsërisë krimin siç e theksuam në pikën e pare, por ai mund të prishë provat, mund të ndotë procesin me dëshmitarët pasi do të jetë në zyrën e kryetarit të bashkisë dhe do të thërrasë njerëz. Ai e bëri këtë gjë kur ishte në detyrë nëpërmjet Klotilda Bushkës dhe ky është një fakt.



E vërteta e Klotilda Bushkës në gjyqin ndaj Veliajt

3- Erion Veliaj thotë duhet të lirohem se e ka thënë Gjykata Kushtetuese, më njeh si kryetar bashkie

Po. Gjykata Kushtetuese e njeh si kryetar bashkie për faktin se shkarkimi që iu bë nga Këshilli Bashkiak i kryeqytetit ishte i paligjshëm.

Por Gjykata Kushtetuese nuk e ka thënë në asnjë rresht që Erion Veliaj duhet të kthehet në detyrë. Gjykata Kushtetuese e ka njohur si kryetar bashkie në detyrë. Po Erion Veliaj është kryetar bashkie në detyrë dhe Gjykata e Lartë duhet të argumentojë pse duhet të qëndrojë në qeli.



Gjykata Kushtetuese urdhëron Gjykatën e Lartë të bindë Veliajn pse duhet të rrijë në burg

Mjafton logjika që kanë përdorur vetë analfabetët juridikë të kryebashkiakut të Tiranës se ai duhet të kthehet në detyrë se e kërkon sovranin për çfarë e kërkon sovranin lind pyetja: Që të shkojë të bëjë të njëjtat krime, që të bëjë korrupsion apo të prishë procesin?

Se svorani nuk e çoi në zyrë Erion Veliajn që të përsëriste 9 herë veprën penale të korrupsionit dhe të firmoste qindra mijëra euro si përfitime për ofj-të e bashkëshortes së tij dhe familjarëve të saj.

Një arsye më shumë pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta çojë në zyrë sërish është pikërisht argumenti që përdor Veliaj dhe ky është arsyetimi që ka dhënë kjo gjykatë në raste të tjera të mëparshme ku ka theksuar se ky njeri, pra Erion Veliaj nuk mund të shkojë në zyrë sepse rrezikon të përsërisë të njëjtin krim të njëjtat veprat penale. Këto janë thelbi i gjithçkaje që pritet të ndodhë nesër në Gjykatën e Lartë.



Zbardhet vendimi i Apelit të GJKKO-së: Veliaj, rrezik për helmimin e provave

Si mundet një Gjykatë e Lartë ta lirojë Erion Veliajn i cili nuk pranon të gjykohe?

Si mundet një Gjykatë e Lartë të kthejë në detyrë ose prap në zyrë personin i cili rrezikon të përsërisë të njëjtat vepra penale?



A mund të lirohet apo t'i zbutet masa e sigurisë dikujt që nuk pranon të gjykohet?


Nuk ka asnjë garanci, asnjë siguri që nuk i përsërit më.

Si mund të kthehet në të njëjtën zyrë i njëjti person i cili prej 14 muajsh nuk shkon të gjykohet dhe nuk pranon të gjykohet dhe prej 19 muajsh ka bërë një sulm kriminal ndaj drejtësisë, që nga gjyqtarët e masave të sigurisë, gjyqtarët e GJKKO, te prokurorët me shpifje e mashtrime që ku nuk janë çuar dhe çfarë nuk është paguar, thasë me para këto dhe të deklaruar, (nuk dimë ato që nuk janë deklaruar dhe çfarë bëhet nën rrogë, dimë këto që janë në sipërfaqe).



FAKTET-Veliaj, 430 mijë dollarë lobim kundër SPAK-ut dhe drejtësisë

Këto janë tre arsye pse Erion Veliaj nuk mund të lihet i lirë nga Gjykata e Lartë, sepse Gjykata e Lartë nuk mund të firmosë dhe vulosë kthimin e Erion Veliajt në vendin e krimit./
CNA





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

[Avokati i pandehur mashtron për llogari të Veliajt](#)

[Rritja e pagave për magjistratët/ Komisioni i Ekonomisë miraton draftin](#)

[Kërkoi ndryshim të masës së sigurisë/ Shtyhet seanca në GJKKO për Metën](#)

[Kërcënimi me jetë ndaj gazetarit/ Reagon SafeJournalists](#)

[Kontrolle blic në burgun ku ndodhet Ergys Agasi/ Ja çfarë u sekuestrua](#)

[Nesër kreu i "5D" pret lirinë, por a do të mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?!](#)

[Kontratat 1 euro/ Hapet rruga për blerjen e pronës, shteti mund ta rimarrë nëse shkelen kushtet](#)

[VIDEO/ Goditi me grusht protestuesin, pezullohet efektivi i "Shqiponjave"](#)

[Pas skandalit me abuzimet/ Ish-deputeti socialist emërohet drejtor i Postës Shqiptare](#)

[Publikoi materialin filmik për protestën/ Kërcënohet me jetë gazetari](#)

[Pagat e magjistratëve/ Rama: Historia e botës s'e ka parë që t'i marrin vetë nga thesari](#)

[Bllokuan lëvizjen në akset kryesore/ Procedohen penalisht 20 protestues](#)

[Gara për kryeprokuror në ngërç/ Kërkohet përjashtimi i anëtarit të KLP-së](#)

A mund të lirohet apo t'i zbutet masa e sigurisë dikujt që nuk pranon të gjykohet?

Seanca në GJKKO, shtyhet gjyqi për dosjen “Partizani”

Nisja e vitit shkollor/ Hita mesazh urimi: Na priftë e mbara! Për sigurinë tuaj nuk bëjmë kompromis

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.